

Burimet: deklarata X.G, FDH-32799; deklarata S.G, FDH-13452; *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vreme oruzanih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDH-20114; KMKRFJ, *Personat.*, FDH-10832; KMDLNJ, *Buletini*, num. 6, janar-mars 1998, 60, FDH-23807.

Avdi (Hagji) Baliu

(19.04.1938, shqiptar nga Turiqeci/Turićevac, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtime, pesë fëmijë)

Forcat e mëdha serbe kanë hyrë në Turiqec/Turićevac më **5.03.1998**. Familja e Avdiut e ka braktisur fshatin, por ai ndenji në shtëpi. Ishte i bindur se asgjë të keqe nuk do të mundte t'i ndodhte, sepse para lufte ishte përfshirë në një aksident rrugor, që ka rezultuar me paralizën e tij gati të tërësishtme. Kushëriri i Avdiut, Azemi, i kishte vërejtur tre ushtarë serb që u ndan nga grupi i ushtarëve dhe e thyen derën e shtëpisë së Avdiut [**Turiqec/Turićevac**]. Pas pak, nga shtëpia u dëgjuan të shtënat. Pastaj, ushtarët shkuan drejt udhëkryqit Skënderaj/Srbica - Klinë/Klina. Azemi shkoi menjëherë te shtëpia e Avdiut. E gjeti Avdiun të vranë në krevat, me plagët nga plumbat nëpër tërë trupin. E ka lënë ashtu të vranë në shtëpi, sepse kishte drojë ta varrose, ngase forcat serbe ende gjendeshin në fshat. Pas tri ditësh [8.03.1998], Azemi dhe axha i tij me disa ushtarë të UÇK-së e kanë varrosur Avdiun në varrezat e Kopilicqit të Ulët/Donji Obilić, në afërsi të lagjes ku jetonte Avdiu.

Burimi: deklarata A.B, FDH-17328.

Ali (Rrahman) Smajli

(korrik 1942, shqiptar nga Turiqeci/Turićevac, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, katër fëmijë)

Në ditën kur forcat serbe kanë hyrë në Turiqec/Turićevac, më **5.03.1998**, Aliu gjendej në shtëpinë e vet familjare me bashkëshorten Zahiden, të atin Rrahmanin, të rejën Mendohijen dhe nipin e vogël Fatbardhin. Tre ushtarë kanë hyrë në shtëpi menjëherë pasi Aliu doli dhe shkoi në ahur për t'i dhënë ushqim bagëtisë. I keqtrajtuat Zahiden dhe të rejën me foshnjën e vogël dhe pastaj i përzunë në rrugë. Menjëherë

pas kësaj, Zahidja me të rejën dhe nipin shkuan në Runik/Rudnik. Ditën tjetër, ajo u kthye në fshat. E gjeti atje vetëm babanë e Aliut, Rrahmanin. Shtëpia ishte e demoluar dhe e plaçkitur. Rrahmani i tha se ushtarët e kishin marrë arrin dhe stollitë e tjera të rejës Menduhijes, por nuk diti çfarë kishte ndodhur me Aliun [**Turiqec/Turićevac**]. Pastaj, Rrahmani dhe Zahidja së pari shkuan te pozicionet e forcave serbe në bregun e Burojë/Bročna dhe atje u interesuan për fatin e Aliut. Atje, u thanë që të shkonin në stacionin policor të Klinës/Klina. Nga Klina i dërguan në Pejë/Peć, ku policët u treguan fotografitë e njerëzve që kanë pësuar në konfliktet e fundit. Fotografia e Aliut ishte në mesin e tyre. E kishte një plagë në kokë. Policët thanë se Aliun e kishin varrosur te vendi i quajtur *Dy Lisat/Dva hrasta* në fshatin Gjurgjevik i Vogël/Mali Đurđevik [Klinë/Klina]. Familjarët vendosën ta linin trupin e Aliut të prehet për një kohë atje ku e kishin varrosur. Pas lufte, në muajin gusht të vitit 1999, një ekip i ekspertëve ndërkombëtar i ka zhvarrosur mbetjet mortore të Aliut. Pas identifikimit, familjarët i kanë riarrosur mbetjet mortore të Aliut më 27.06.2001 në varrezat e Turiqecit/Turićevac.

Burimet: deklarata Z.S, FDH-17244; deklarata Z.S, FDH-32018; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 58, FDH-23857.

Bashkim (Ali) Sadiku

(20.05.1977, shqiptar nga Tushila/Tušilje, komuna e Skënderajt/Srbica, student, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Bashkimi me familje jetonin në Tushilë/Tušilje. Ka qenë student, por finançohej nga puna në ndërtimtari. Aderoi në UÇK më 20.12.1997. Ishte pjesëtar më i ri në njësitin e UÇK-së në fshatin e tij. Në datën **5.03.1998**, Bashkimi me njësitin e vet i vëzhgonin forcat serbe që ishin të stacionuara në afërsi të fshatit, te vendi i quajtur *Te Tabat* [**Tushilë/Tušilje**]. Rreth orës 18:00, Bashkimi u nis vetëm për t'i vëzhguar nga afër forcat serbe. Një orë më vonë, u dëgjuan të shtënat nga drejtimi nga i cili ai shkoi. Një ditë më vonë, bashkëlufetarët e Bashkimit i kanë gjetur